

KËRKESË
Nr. 115/11, datë 7.6.2022

PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS
PËR INTERES PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose shkëmbimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim Laç 1/2, Bashkia Kurbin, faza 1.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi dhe “ndërtesë”, me funksion jobanimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, bazuar në çmimet mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit, për vitin 2016.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Kurbin, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 9,737,387 (nëntë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT
Erlis Hereni

